



RAPORT I EKSPERTËVE NDARJA E SHOQËRISË Hekurudha Shqiptare sha

31 GUSHT 2023

PËRGATITUR NGA:

SOKOL TOSKA
AIDA MALOKU
VULLNETARE ÇELA

PËRGATITUR PËR:

Shoqërinë Hekurudha Shqiptare sha



Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

PASQYRA E LËNDËS

1.	TË PËRGJITHSHME	5
1.1.	RETH SHOQËRISË HEKURUDHA SHQIPTARE SHA QË NDAHET.....	5
1.2.	RETH SHOQËRIVE PRITËSE	5
1.3.	QËLLIMI I RAPORTIT.....	6
1.4.	BURIMI I INFORMACIONIT	6
1.5.	PËRDORIMI I RAPORTIT	6
2.	RAPORTI I KËMBIMIT TË AKSIONEVE.....	7
2.1.	PRONËSIA E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE QË REZULTOJNË NGA NDARJA.	7
2.2.	NDARJA ME PRONËSI TË DREJPËRDREJTË.....	8
2.3.	NDARJA SI GRUP I KONTROLLUAR (HOLDING).....	9
2.4.	VLERA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE PRITËSE.....	11
2.5.	ANALIZA E FORMAVE TË PRONËSISË SË AKSIONEVE.	12
3.	ÇËSHTJE TË TJERA	13
3.1.	PROCEDURAT LIGJORE TË NDARJES.....	13
3.2.	DEKLARIMET PËR PUNËMARRËSIT	13
3.3.	TRANSFERIMI I DOKUMENTACIONIT	14
3.4.	MARRJA NË DORËZIM E AKTIVEVE	14
4.	ANALIZA E PASQYRAVE FINANCIARE.....	15
4.1.	RIPARAQITJA E BILANCIT PARAARDHËS NË DATËN 31.12.2022.	15
4.2.	BILANCI I NDARJES NË DATËN 30.6.2023 DHE PARIMET E ZBATUARA.	16
4.3.	RREGULLIMET NË BILANCIN E NDARJES.....	19
4.3.1.	KOMENTE MBI RREGULLIMET PËR REZERVËN E RIVLERËSIMIT.....	20
4.3.2.	KOMENTE MBI RREGULLIMET PËR LLOGARITË E ARKËTUESHME.....	21
4.3.3.	KOMENTE MBI RREGULLIMET PËR DETYRIMET TREGTARE.....	22
4.3.4.	KOMENTE MBI RREGULLIMET PËR INVENTARËT.....	23
4.4.	BILANCI I NDARJES NË DATËN 30.6.2023 PAS RREGULLIMEVE.....	24
4.5.	KOMENTE MBI AKTIVET AFATGJATA	26
5.	KONKLUZIONE	27

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

1. Të përgjithshme

1.1. Reth shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha që ndahet.

Të dhënat e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha janë si vijon.

Statusi juridik:	Shoqëri Aksionare me dy nivele
Aksionari:	Ministria e Financave dhe Ekonomise zotëron 100% të aksioneve
Kapitali i regjistruar:	47,450,830,000 lekë, i ndarë në 47,450,830 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion
Selia:	Lagjja nr.3, Rruga Egnatia, Durrës
Data e themelimit:	17.11.2000
Administrator i Shoqërisë:	Z. Gentian Liko
Numri unik i regjistrimit:	J61811547D

Sipas Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr. 1219 Prot, datë 21.01.2022, dhe Nr. 1219/2 Prot, datë 22.09.2022, shoqëria Hekurudha Shqiptare sha do të ndahet në katër shoqëri aksionare.

Administratori i shoqërisë ka hartuar Projekt marrëveshjen e Ndarjes të datës 15.08.2023, bazuar në vendimet e Aksionarit, Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Procedura e ndarjes do të realizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar si dhe në pajtim me Ligjin Nr. 90/2021 “Për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha”.

1.2. Reth shoqërive pritëse.

Sipas akteve ligjore dhe dokumentave që përmenden në paragrafin më sipër, shoqëria Hekurudha Shqiptare Sha do të ndahet në katër shoqëri aksionare si vijon.

1. Administruesi i Infrastrukturës sha
2. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha
3. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha
4. Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha

Shoqëritë pritëse do të themelohen rishtazi në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar si dhe me Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.

Të dhënat e regjistrimit të shoqërive pritëse janë përcaktuar në projekt marrëveshjen e ndarjes ndërsa objekti bazë i aktivitetit si dhe parimet e administrimit të tyre janë përcaktuar në Ligjin Nr. 90/2021 “Për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha” dhe do të detajohen më tej në aktet e tyre themeluese dhe në statutin përkatës.

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

1.3. Qëllimi i Raportit.

Ky raport hartohet në përputhje me parashikimet e nenit 217 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar si dhe në përmbushje të detyrave të caktuara nga aksionari në vendimet Nr. 1219 Prot, datë 21.01.2022, dhe Nr. 1219/2 Prot, datë 22.09.2022.

Qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me vlerësimin e procesit dhe të projekt marrëveshjes së ndarjes të shoqërisë Hekurudha Shqiptare. Ne kemi verifikuar vlerat përkatëse të bilanceve të shoqërisë që do të ndahet dhe të shoqërive pritëse nëse janë të sakta dhe në përputhje me projekt marrëveshjen e ndarjes si dhe nëse raporti i këmbimit të aksioneve është i drejtë dhe i arsyeshëm. Ne kemi zbatuar procedura si vijon.

- Analizë e të dhënave të shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha për statusin e saj ligjor dhe strukturën e kapitalit të shoqërisë.
- Vlerësimin e përputhshmërisë së kriterëve të propozuara të ndarjes së aktiveve, nëse janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe vendimet e asamblesë.
- Vlerësimi financiar dhe kontabël i bilancit të gjendjes të shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha, i paraqitur për ndarje.
- Eksplorimin e mundësive të ndryshme për të përcaktuar këmbimin e aksioneve, vlerësimi i përshtatshmërisë së metodës së zbatuar si dhe gjykime mbi vlerën e rezultuar të kapitalit dhe të kontributeve që e përfaqësojnë atë.
- Vlerësimi dhe analiza e transaksioneve të kryera deri në ditën e hartimit të këtij raporti dhe vlerësimi nëse Administratori i ka paraqitur këto transaksione në mënyrë transparente për aksionarin e shoqërisë.

1.4. Burimi i Informacionit.

Si bazë mbi të cilat do të bëhet ndarja do të jetë pasqyra kontabël e gjendjes financiare të shoqërisë në datën 30.06.2023. Jemi bazuar në Bilancin kontabël të Shoqërisë Hekurudha Shqiptare Sha, i datës 30.06.2023, si dhe të gjithë inventarët e llogarive që janë përdorur si bazë për përgatitjen e Marrëveshjes së ndarjes, që referohen në datë 30.06.2023.

Jemi bazuar në informacionin e marrë nga grupi i punës në shoqërinë Hekurudha Shqiptare sha i ngritur për qëllimin e ndarjes. Gjithashtu, kemi zhvilluar takime dhe komunikime të rregullta me personelin dhe grupe specialistësh inxhinier/teknik si dhe ekonomik të shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha.

Gjithashtu, kemi shqyrtuar dhe referuar edhe protokollin e komunikimit midis Administratorit të shoqërisë dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga data 29.06.2023 deri në datën 21.07.2023, përfshi diskutimet e bëra në takimin e datës 17.07.2023 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

1.5. Përdorimi i Raportit.

Ky raport duhet të përdoret vetëm për qëllimin e përmendur më lart dhe i shërben vetëm Asamblesë së Përgjithshme për të marrë vendim mbi ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha. Raporti nuk duhet riprodhuar në mënyrë të pjesëshme.



2. Raporti i këmbimit të aksioneve.

2.1. Pronësia e aksioneve të shoqërive që rezultojnë nga ndarja.

Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” parashikon bërjen e aksionarëve të shoqërisë që ndahet aksionarë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes.

Ligji 90/2021 gjithashtu, parashikon bërjen e aksionarëve të shoqërisë Hekurudha Shqiptare sh.a, në aksionarë të shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes.

Në projekt marrëveshjen e ndarjes përcaktohet se Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të zotërojë 100 përqind të aksioneve të të katër shoqërive pritëse.

Në nenin 217 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, kërkohet nga ekspertët që të shprehen për metodat që mund të përdoren për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve, nëse këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metode, për të arritur në vlerën e vendosur

Në analizën e rastit janë identifikuar dy mundësi për metodën e këmbimit të aksioneve si përshkruajmë në vijim.

1. Aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron drejtpërdrejt 100 përqind aksionet e secilës nga katër shoqëritë pritëse;
2. Aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron drejtpërdrejt 100 përqind aksionet e shoqërisë pritëse Administruesi i Infrastrukturës sha dhe gjithashtu zotëron 100 përqind aksionet e secilës nga tre shoqëritë e tjera pritëse nëpërmjet shoqërisë Administruesi i Infrastrukturës sha, duke krijuar kështu një grup të kontrolluar.

Referuar protokollit të komunikimit midis Administratorit të shoqërisë dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga data 29.06.2023 deri në datën 21.07.2023, përfshi diskutimet e bëra në takimin e datës 17.07.2023 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, është trajtuar çështja e formës së pronësisë së aksioneve të shoqërive pritëse dhe gjithashtu edhe përfaqësuesit e aksionarit Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kërkojnë nga grupi i ekspertëve të përfshijnë në raport një analizë lidhur me përfitimet dhe mangësitë që paraqet secila nga format e propozuara.

Për këtë, në vijim po paraqesim ndarjen e realizuar sipas secilës nga dy metodat e përshkruara më sipër si dhe mendimet për rëndësinë relative të secilës prej tyre.



Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

2.2. Ndarja me pronësi të drejtpërdrejtë.

Në këtë rast, aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron drejtpërdrejt 100 përqind aksionet e secilës nga katër shoqëritë pritëse. Një paraqitje skematike e pronësisë së shoqërive pritëse pas ndarjes jepet në vijim.



Aksionet e secilës nga katër shoqëritë pritëse, Administruesi i Infrastrukturës sha, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha dhe Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha zotërohen në nivelin 100 përqind nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Aksionet do të jenë aksione të zakonshme, nuk do të ekzistojnë aksione me të drejta të veçanta apo preferencialë, apo të drejta të tjera të veçanta. Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të gjitha aksionet dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin si pasojë e zotërimit të 100 përqind të aksioneve për secilën nga katër shoqëritë pritëse.

Nga ky këmbim i aksioneve të shoqërisë që ndahet me aksionet e shoqërive pritëse, nuk rezulton asnjë shumë e pagueshme në para.


Pronësia e aksioneve të shoqërive pritëse paraqitet skematikisht si vijon.

Shoqëria Pritëse	Aksionari	Përqindja e kontrollit
Administruesi i Infrastrukturës sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kontroll i drejtpërdrejtë 100 përqind nga MFE
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kontroll i drejtpërdrejtë 100 përqind nga MFE
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kontroll i drejtpërdrejtë 100 përqind nga MFE
Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kontroll i drejtpërdrejtë 100 përqind nga MFE

Bazuar në sa më sipër, meqenëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron 100 përqind të aksioneve të shoqërisë që ndahet Hekurudha Shqiptare sha, ky propozim mbi pronësinë e aksioneve të shoqërive pritëse respekton raportin e këmbimit të aksioneve dhe është i drejtë dhe i arsyeshëm.

2.3. Ndarja si grup i kontrolluar (holding).

Në këtë rast, aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron drejtpërdrejt 100 përqind aksionet e shoqërisë pritëse Administruesi i Infrastrukturës sha dhe secila nga tre shoqëritë e tjera pritëse zotërohet 100 përqind nga shoqëria Administruesi i Infrastrukturës sha, e cila sillet si shoqëri mëmë. Një paraqitje skematike e pronësisë së shoqërive pritëse pas ndarjes jepet në vijim.



Sipas ndarjes më sipër, shoqëritë pritëse organizohen në formën e një grupi të kontrolluar (holding), ku aksionet e shoqërisë pritëse Administruesi i Infrastrukturës sha zotërohen në nivelin 100 përqind nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe aksionet e tre shoqërive të tjera pritëse Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha dhe Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha zotërohen në nivelin 100 përqind nga shoqëria Administruesi i Infrastrukturës sha (shoqëria mëmë), duke rezultuar në zotërim të tërthortë 100 përqind nga aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Aksionet e shoqërisë pritëse Administruesi i Infrastrukturës sha do të jenë aksione të zakonshme, nuk do të ekzistojnë aksione me të drejta të veçanta apo preferencialë, apo të drejta të tjera të veçanta. Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të gjitha aksionet dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin si pasojë e zotërimit të 100 përqind të aksioneve.

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

Aksionet e tre shoqërive të tjera pritëse, përkatësisht, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha dhe Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha, do të jenë aksione të zakonshme, nuk do të ekzistojnë aksione me të drejta të vecanta apo preferencialë, apo të drejta të tjera të vecanta. Shoqëria Administruesi i Infrastrukturës sha zotëron të gjitha aksionet dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin si pasojë e zotërimit të 100 përqind të aksioneve.

Nga ky këmbim i aksioneve të shoqërisë që ndahet me aksionet e shoqërive pritëse, nuk do të rezultojë asnjë shumë e pagueshme në para.

Pronësia e aksioneve të shoqërive pritëse paraqitet skematikisht si vijon.

Shoqëria Pritëse	Aksionari	Përqindja e kontrollit
Administruesi i Infrastrukturës sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kontroll i drejtpërdrejtë 100 përqind nga MFE
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha	Administruesi i Infrastrukturës sha	Kontroll i tërthortë 100 përqind nga MFE
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha	Administruesi i Infrastrukturës sha	Kontroll i tërthortë 100 përqind nga MFE
Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha	Administruesi i Infrastrukturës sha	Kontroll i tërthortë 100 përqind nga MFE

Bazuar në sa më sipër, meqenëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron 100 përqind të aksioneve të shoqërisë që ndahet Hekurudha Shqiptare sha, ky propozim mbi pronësinë e aksioneve të shoqërive pritëse respekton raportin e këmbimit të aksioneve dhe është i drejtë dhe i arsyeshëm.



Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

2.4. Vlera e kapitalit të shoqërive pritëse.

Vlera e kapitalit të shoqërive pritëse krijohet nga transferimi i aktiveve dhe detyrimeve nga shoqëria që ndahet Hekurudha Shqiptare sha.

Në rastin e *ndarjes me pronësi të drejtpërdrejtë*, kapitali do të ndahet midis shoqërive pritëse dhe vlera e kapitalit të zotëruar nga aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të jetë e barabartë me shumën e kapitalit të katër shoqërive pritëse.

Në vijim po paraqesim strukturën e pronësisë së aksioneve të shoqërive pritëse që rezultojnë nga ndarja me pronësi të drejtpërdrejtë e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha si dhe vlerën e kapitalit aksionar për secilën shoqëri, siç rezulton nga llogaritjet në paragrafët në vijim.

Shoqëria Pritëse	Aksionari 100%	Vlera e kapitalit Lek	Numri i aksioneve copë	Vlera Lek për aksion
Administruesi i Infrastrukturës sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	38,547,282,000	38,547,282	1,000
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	106,856,000	106,856	1,000
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	101,718,000	101,718	1,000
Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	400,767,000	400,767	1,000
Shuma	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	39,156,623,000	39,156,623	1,000

Në rastin e *ndarjes me një grup të kontrolluar*, vlera totale e kapitalit të grupit është e barabartë me vlerën e kapitalit të shoqërisë mëmë dhe kjo përbën vlerën e kapitalit të zotëruar nga aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Pra, pavarësisht se vlera e kapitalit të shoqërive të kontrolluara (shoqëri bija) i referohet pasurive dhe kontributeve konkrete, kjo vlerë nuk mblidhet me vlerën e kapitalit të shoqërisë mëmë por është pjesë e tij. Ky pohim vlen edhe për paraqitjen në bilancin individual të shoqërisë Administruesi i Infrastrukturës sha ashtu edhe në bilancin e konsoliduar të grupit.

Në vijim po paraqesim strukturën e pronësisë së aksioneve të shoqërive pritëse që rezultojnë nga ndarja me një grup të kontrolluar e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha si dhe vlerën e kapitalit aksionar për secilën shoqëri, siç rezulton nga llogaritjet në paragrafët në vijim.

Shoqëria Pritëse	Aksionari 100%	Vlera e kapitalit Lek	Numri i aksioneve copë	Vlera Lek për aksion
Administruesi i Infrastrukturës sha	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	39,156,623,000	39,156,623	1,000
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha	Administruesi i Infrastrukturës sha	106,856,000	106,856	1,000
Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha	Administruesi i Infrastrukturës sha	101,718,000	101,718	1,000
Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha	Administruesi i Infrastrukturës sha	400,767,000	400,767	1,000

Sikurse shihet, në të dyja rastet, vlera totale e kapitalit aksionar të **zotëruar nominalisht nga aksionari Ministria e Financave dhe Ekonomisë është 39,156,623,000 lekë.**

2.5. Analiza e formave të pronësisë së aksioneve.

Referuar pohimeve dhe analizave të paraqitura në kapitullin 2 të këtij raporti, rezulton se pavarësisht formës së zgjedhur për pronësinë e aksioneve të shoqërive pritëse, vlera e kapitalit të zotëruar nga aksionari i vetëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë është i njëjtë.

Gjithashtu, pavarësisht formës së zgjedhur për pronësinë e aksioneve të shoqërive pritëse, secili propozim respekton raportin e këmbimit të aksioneve dhe është i drejtë dhe i arsyeshëm.

Në këtë kuptim, në analizën e rëndësisë relative të secilës metodë, argumentat që mund të përdoren janë të natyrës politiko-tregtare dhe të efikasitetit operacional të shoqërive që krijohen nga ndarja.

Bazuar në parashikimet e ligjit 90/2021 si dhe në rekomandimet e konsulentit ndërkombëtar, ndarja e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha bëhet me qëllim që sektori të integrohet në një treg konkurrues si dhe që të përmirësohet efikasiteti i sistemit hekurudhor. Gjithashtu, konsulenti thekson se për ta bërë transportin hekurudhor efikas dhe konkurrues me mënyrat e tjera të transportit, si dhe për të mbështetur zhvillimin e tij në të ardhmen, duhet të sigurohet që:

- a. *Sipërmarrësit hekurudhore të kenë statusin e operatorëve të pavarur që sillen në përputhje me nevojat e tregut.*
- b. *Të bëhet dallimi ndërmjet ofrimit të shërbimeve të transportit dhe operimit të infrastrukturës.*


E njëjta politikë konstatohet edhe në ligjin 90/2021, ku paraqiten parashikime të posaçme për shoqërinë Administruesi i Infrastrukturës dhe parashikime të ngjashme për Sipërmarrësit.

Në analizën që mund të bëjmë, të dyja metodat e propozuara i respektojnë parimet e përcaktuara më sipër. Më shumë mund të theksojmë si vijon.

Organizimi me pronësi të drejtpërdrejtë nga vetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, rezulton me një nivel më të lartë pavarësie të shoqërive nga njëra tjetra. Kjo nga pikpamja politiko-tregtare mund të jetë pozitive por nga pikpamja e administrimit mund të rezultojë me mospërputhje të objektivave, veprime të pakoordinuara, rritje të kostove administrative, etj. Për shoqëritë pritëse, ofrimi i shërbimeve efikase me koston më të ulët të mundshme, është çështje e theksuar në nenin 7 të ligjit 90/2021.

Organizimi si grup kontrollues, rezulton me një kontroll vertikal më të përqëndruar dhe nivel më të ulët të pavarësisë së shoqërive të kontrolluara por do të jetë më eficient nga pikpamja e administrimit, kosto më të ulëta administrative dhe manaxheriale, politika tregtare më të koordinuara, nivel më të ulët të burokracisë, vendimmarrje dhe reagim më të shpejtë ndaj tregut dhe faktorëve të tjerë të mjedisit tregtar. Nga ana tjetër, *sipërmarrësit* midis tyre kanë pavarësi dhe mikroadministrimi i tyre është i pavarur nga njëri tjetri, ndërsa krijohet një dallim i qartë midis *shërbimeve të transportit dhe operimit të infrastrukturës*.

Në konkluzion të këtij paragrafi, përzgjedhja e metodës së pronësisë së aksioneve të shoqërive pritëse mbetet në vullnetin, strategjinë tregtare dhe politikat e aksionarit.



3. Çështje të tjera.

3.1. Procedurat ligjore të ndarjes.

Ndarja e shoqërisë është nisur me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr. 1219, datë 21.01.2022, ndryshuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr. 1219/2 Prot, datë 22.09.2022. Këto vendime kanë ngarkuar Administratorin me përgatitjen e projekt marrëveshjes së ndarjes si dhe kanë caktuar dhe ngarkuar ekspertët të përgatisin raportin e ndarjes. Ky vendim duhet të depozitohet në QKB.

Projekt marrëveshja e ndarjes e hartuar nga Administratori në datën 15.08.2023 si dhe ky raport i ekspertëve për ndarjen duhet të shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Mbikqyrës dhe më pas, së bashku me pasqyrat financiare vjetore 2020, 2021 dhe 2022 si dhe pasqyrën kontabël për gjendjen e shoqërisë në datën 30.06.2023 duhet të depozitohen në QKB të paktën një muaj para vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit për miratimin e tyre. Ky afat jepet me qëllim njohjen e projektit nga publiku dhe njoftimin e pretendimeve të mundshme nga palë të treta për efektet që mund të ketë ndarja në interesat e tyre apo të palëve të tjera të interesuara. Pas përfundimit të këtij afati, duhet të kryhen korrigjimet apo ndryshimet përkatëse në Projekt marrëveshjen e Ndarjes, sipas rrethanave që mund të shfaqen dhe të gjitha aktet ti paraqiten Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit për miratimin e tyre.

Vendimi i Asamblesë së Aksionarit që miraton aktet e përshkruara në paragrafin më sipër, së bashku me Marrëveshjen e Ndarjes të nënshkruar nga Administratori (projekt marrëveshja e miratuar) depozitohen në QKB për të konkluduar procesin e ndarjes. Gjithashtu, në këtë fazë duhet të depozitohen edhe Statutet dhe Aktet Themeluese të shoqërive të reja që krijohen nga ndarja.

3.2. Deklarimet për punëmarrësit.

Në nenin 138 të Kodit të Punës parashikohet se në rast transferimi të ndërmarrjes ose të një pjese të saj, të drejtat dhe detyrimet që rrejdhin prej tij, në bazë të një kontrate pune që është në fuqi deri në momentin e transferimit, i kalojnë personit që i transferon këto të drejta.

Në lidhje me punonjësit, njësia Hekurudha Shqiptare sha duhet të ketë në vëmendje të bëjë largimin e të gjithë punonjësve nëpërmjet formularit ESIG027 në referim me datën e hyrjes në fuqi të ndarjes, e cila është përcaktuar në projekt marrëveshjen e ndarjes si data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të Marrëveshjes së Ndarjes pas miratimit nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, në përputhje me parashikimet e neneve 220 dhe 227 të Ligjit Tregtar.

Gjithashtu, shoqëritë pritëse duhet të bëjnë marrjen në punë të punonjësve nëpërmjet formularit ESIG027 në referim me datën e hyrjes në fuqi të ndarjes, duke respektuar edhe afatet ligjore të përcaktuara në ligjet tatimore.



Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

3.3. Transferimi i dokumentacionit.

Pas procesit të regjistrimit të shoqërive të reja si pasojë e ndarjes, duhet që shoqëria Hekurudha Shqiptare sha të përgatisë dhe të kalojë dokumentacionin përkatës që i takon secilës shoqëri pritëse, si libra kontabël, inventarët e aseteve, listat e punonjësve me të dhënat personale përkatëse si dhe çdo dokument tjetër që i takon shoqërive pritëse.

3.4. Marrja në dorëzim e aktiveve.

Transferimi i aktiveve nga shoqëria që ndahet dhe kalimi i tyre fizikisht tek shoqëria pritëse duhet të bëhet me procesverbal dorëzimi nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të shoqërisë që ndahet dhe të atyre pritëse. Për këtë është e nevojshme të ngrihen grupe punë nga të gjitha shoqëritë që janë të përfshira në këtë process. Për procedurat e transferimit duhet referuar VKM nr. 510, datë 10.06.2015.

Gjithashtu, pas ndarjes, shoqëritë pritëse duhet të veprojnë për regjistrimin e aktiveve afatgjata të paluajtshme, toka dhe ndërtesa në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës dhe automjetet në Drejtorinë e Transportit Rrugor. Këto regjistrime duhen kryer brenda afateve ligjore përkatëse.

Në referim të nenit 16 të ligjit Nr. 92/2014 datë 24.7.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, shoqëria Hekurudha Shqiptare SHA duhet të lëshojë faturë tatimore shitje në favor të shoqërive pritëse për transferimin e tërësisë së pjesëshme të aseteve. Dokumentimi me faturë tatimore është parashikuar në pikën 6.i në nenin 21 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”. Shoqëria Hekurudha Shqiptare SHA si dhe shoqëritë pritëse duhet të përmbushin kërkesat e parashikuara në nenin 21 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, posaçërisht pika 2.a dhe 6 e tij, lidhur me njoftimet e autoritetit tatimor dhe afatet përkatëse.

4. Analiza e pasqyrave Financiare.

4.1. Riparaqitja e Bilancit paraardhës në datën 31.12.2022.

Në funksion të analizës sa më të qartë të ndarjes së bilancit si dhe për të siguruar krahasueshmëri, bilanci i periudhës paraardhëse 31.12.2022 është riparaqitur, duke grupuar më mirë llogaritë sipas natyrës si dhe duke shprehur më mirë pritshmërinë për shlyerjen e detyrimeve në kohë. Në vijim paraqitet një diagramë krahasuese e bilancit të shoqërisë në datën 31.12.2022 siç është publikuar si dhe riparaqitjes që kemi aplikuar së bashku me diferencat përkatëse.

<i>(Të gjitha vlerat në Lek)</i>	<i>31/12/2022 Riparaqitur</i>	<i>31/12/2022 Si ishte</i>	<i>Ndryshimi</i>
AKTIVET			
<i>Aktive afatshkurtra</i>			
Mjete monetare	1,468,881	1,468,881	0
Disponibilitete në thesar	75,963,853	11,209,445	64,754,408
Llogari të arkëtueshme	120,984,337	185,738,745	(64,754,408)
Inventarët	396,408,834	396,408,834	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	594,825,903	594,825,903	0
<i>Aktivitet afatgjata</i>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	77,978,609,564	77,978,609,564	0
Totali i aktiveve afatgjata	77,978,609,564	77,978,609,564	0
Totali i aktiveve	78,573,435,467	78,573,435,467	0
DETYRIMET DHE KAPITALI			
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>			
Garanci të mbajtura	76,241,361	11,209,445	65,031,916
Llogaritë e pagueshme tregtare	178,050,545	527,558,971	(349,508,426)
Te pagueshme për punonjësit dhe sigurimet	31,434,344	31,434,344	0
Të pagueshme për detyrime tatimore	881,147	26,813,184	(25,932,037)
Parapagime të arkëtuara	36,149,353	36,149,353	0
Të pagueshme të tjera	6,752,194	6,752,194	0
Grande për investime	0	457,025,404	(457,025,404)
Totali i detyrimeve afatshkurtra	329,508,944	1,096,942,895	(767,433,951)
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Huamarrjet afatgjata	657,422,289	657,422,289	0
Llogaritë e pagueshme tregtare	1,065,941,510	781,465,000	284,476,510
Të pagueshme të tjera	25,932,037	0	25,932,037
Grande për investime	457,025,404	0	457,025,404
Provizione për shpenzime	237,250,000	237,250,000	0
Totali i detyrimeve afatgjata	2,443,571,240	1,676,137,289	767,433,951
Totali i detyrimeve	2,773,080,184	2,773,080,184	0
<i>Kapitali dhe fondet e veta</i>			
Kapitali aksionar	47,450,830,000	47,450,830,000	0
Rezerva të rivlerësimit	28,407,680,466	28,407,680,466	0
Fitimet e humbje të mbajtura	2,216,220,396	2,216,220,396	0
Fitimi/humbja e vitit	(2,274,375,579)	(2,274,375,579)	0
Totali i kapitalit dhe fondeve të veta	75,800,355,283	75,800,355,283	0
Totali i detyrimeve, kapitalit dhe fondeve të veta	78,573,435,467	78,573,435,467	0

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

4.2. Bilanci i ndarjes në datën 30.6.2023 dhe parimet e zbatuara.

Bilanci i gjendjes financiare i përgatitur nga shoqëria Hekurudha Shqiptare sha në datë 30.6.2023 paraqitet si vijon.

<i>(Të gjitha vlerat në Lek)</i>	30/6/2023	31/12/2022
AKTIVET		
<i>Aktive afatshkurtra</i>		
Mjete monetare	4,078,804	1,468,881
Disponibilitete në thesar	151,952,987	75,963,853
Llogari të arkëtueshme	106,198,128	120,984,337
Inventarët	396,636,091	396,408,834
Totali i aktiveve afatshkurtra	658,866,010	594,825,903
<i>Aktivet afatgjata</i>		
Prona, impiantet dhe pajisjet	77,637,403,137	77,978,609,564
Totali i aktiveve afatgjata	77,637,403,137	77,978,609,564
Totali i aktiveve	78,296,269,147	78,573,435,467
DETYRIMET DHE KAPITALI		
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Garanci të mbajtura	156,390,495	76,241,361
Llogaritë e pagueshme tregtare	154,929,262	178,050,545
Te pagueshme per punonjesit dhe sigurimet	32,655,124	31,434,344
Të pagueshme per detyrime tatimore	528,332	881,147
Parapagime të arkëtuara	9,861,533	36,149,353
Të pagueshme të tjera	7,805,396	6,752,194
Totali i detyrimeve afatshkurtra	362,170,142	329,508,944
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Huamarrjet afatgjata	657,723,254	657,422,289
Llogaritë e pagueshme tregtare	1,067,807,110	1,065,941,510
Të pagueshme të tjera	25,932,037	25,932,037
Grande për investime	467,278,011	457,025,404
Provizione për shpenzime	237,250,000	237,250,000
Totali i detyrimeve afatgjata	2,455,990,412	2,443,571,240
Totali i detyrimeve	2,818,160,554	2,773,080,184
<i>Kapitali dhe fondet e veta</i>		
Kapitali aksionar	47,450,830,000	47,450,830,000
Rezerva te rivleresimit	28,277,863,813	28,407,680,466
Fitimet e humbje te mbajtura	(58,155,181)	2,216,220,396
Fitimi/humbja e vitit	(192,430,039)	(2,274,375,579)
Totali i kapitalit dhe fondeve të veta	75,478,108,593	75,800,355,283
Totali i detyrimeve, kapitalit dhe fondeve të veta	78,296,269,147	78,573,435,467

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

Bilanci në datën 30.6.2023 është konsideruar si bilanc në datën e ndarjes dhe të gjitha aktivet dhe detyrimet që paraqiten në bilancin e gjendjes do të ndahen, sipas përcaktimeve që përmban projekt marrëveshja e ndarjes si dhe ligji Nr. 90/2021 “Për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha”.

Duke eksploruar metodat e mundëshme të ndarjes së aktiveve dhe pasiveve, ne zbatuam një qasje parimore, në mënyrë që ndarja të jetë e qartë dhe e kuptueshme nga të gjithë personat vendimmarrës.

Kështu, duke referuar projekt marrëveshjen e ndarjes por edhe praktikën e administrimit të shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha, ne arritëm të identifikojmë qartësisht 5 segmente të ndryshme operationale, të cilat mbajnë libra dhe llogari kontabël të veçanta si dhe administrojnë aktivet inventariale në mënyrë të veçantë nga njëra tjetra. Këto segmente referojnë me ndarjen e parashikuar në ligj dhe në këtë mënyrë përbëjnë një bazë shumë të mirë për tu mbështetur për përcaktimin e elementëve të bilancit që do marrë secila shoqëri pritëse.

Në vijim paraqiten skematikisht segmentet e identifikuar dhe referimi me ndarjen e përcaktuar në ligj.

Segmenti aktual ne Hekurudha Shqiptare sha	Shoqëria pritëse
Drejtoria	
NJBMIH (Njësia e biznesit të mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore)	Administruesi i Infrastrukturës sha
NJBU (Njësia e biznesit të udhëtarit)	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha
NJBM (Njësia e biznesit të mallit)	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha
NJSHML (Njësia e shërbimit të mjeteve lëvizëse)	Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha

Pra sikurse shihet, njësitë aktuale Drejtoria dhe Njësia e Infrastrukturës do të përbëjnë bazën e shoqërisë Administruesi i Infrastrukturës sha.

Njësia e biznesit të udhëtarit do të bërë bazën e shoqërisë Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha.

Njësia e biznesit të mallit do të bërë bazën e shoqërisë Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha.

Njësia e shërbimit të mjeteve lëvizëse do të bërë bazën e shoqërisë Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha.

Nga pikpamja praktike, librat kontabël të secilës njësi do të përdoren për të ndarë bilancin e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha sipas kësaj strukture, duke e emërtuar si *parimi i përkatësisë në librat kontabël dhe vendndodhjes fizike të aktiveve inventariale*.

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

Në vijim po paraqesim bilancin e ndarjes të datës 30.6.2023 të shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha si dhe ndarjen e tij në formën e bilanceve të çeljes së shoqërive pritëse në datën 1.7.2023, që rezultojnë sipas parimit të përkatësisë në librat kontabël dhe vendndodhjes fizike të aktiveve inventariale.

	Administruesi i Infrastrukturës	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit	Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore	TOTAL (Bilanci i ndarjes)
<i>(Të gjitha vlerat në Lek)</i>					
	1/7/2023	1/7/2023	1/7/2023	1/7/2023	30/6/2023
AKTIVET					
Aktive afatshkurtra					
Mjete monetare	3,762,021	70,594	220,491	25,698	4,078,804
Disponibilitete ne thesar	151,952,987	0	0	0	151,952,987
Llogari të arkëtueshme	23,403,446	125,899	53,462,386	29,206,397	106,198,128
Inventarët	223,602,260	9,907,053	1,552,926	161,573,852	396,636,091
Totali i aktiveve afatshkurtra	402,720,714	10,103,546	55,235,803	190,805,947	658,866,010
Aktivët afatgjata					
Aktive materiale	76,814,634,245	224,548,154	212,864,123	385,356,615	77,637,403,137
Totali i aktiveve afatgjata	76,814,634,245	224,548,154	212,864,123	385,356,615	77,637,403,137
Totali i aktiveve	77,217,354,959	234,651,700	268,099,926	576,162,562	78,296,269,147
DETYRIMET DHE KAPITALI					
Detyrimet afatshkurtra					
Detyrime të mbajtura në thesar	156,390,495	0	0	0	156,390,495
Llogaritë e pagueshme tregtare	97,568,276	13,143,537	51,550	44,165,899	154,929,262
Te pagueshme per punonjesit dhe sigurimet	20,691,770	4,776,517	4,255,428	2,931,409	32,655,124
Të pagueshme per detyrime tatimore	412,727	41,655	32,124	41,826	528,332
Parapagime te arketuara	1,123,192	0	8,738,341	0	9,861,533
Të pagueshme të tjera	7,225,817	167,439	178,656	233,484	7,805,396
Totali i detyrimeve afatshkurtra	283,412,277	18,129,148	13,256,099	47,372,618	362,170,142
Detyrimet afatgjata					
Huamarrjet afatgjata	657,723,254	0	0	0	657,723,254
Llogaritë e pagueshme tregtare AGj	781,465,000	0	286,342,110	0	1,067,807,110
Të pagueshme të tjera Agj	25,932,037	0	0	0	25,932,037
Grantet dhe të ardhurat e shtyra AGj	467,278,011	0	0	0	467,278,011
Provizione	237,250,000	0	0	0	237,250,000
Totali i detyrimeve afatgjata	2,169,648,302	0	286,342,110	0	2,455,990,412
Totali i detyrimeve	2,453,060,579	18,129,148	299,598,209	47,372,618	2,818,160,554
KAPITALI DHE FONDET E VETA					
Rezerva te rivleresimit	27,994,407,102	120,777,441	102,478,145	60,201,125	28,277,863,813
Aktive Neto	46,769,887,278	95,745,111	-133,976,428	468,588,819	47,200,244,780
Totali i kapitalit dhe fondeve të veta	74,764,294,380	216,522,552	-31,498,283	528,789,944	75,478,108,593
Totali i detyrimeve dhe fondeve të veta	77,217,354,959	234,651,700	268,099,926	576,162,562	78,296,269,147

Për qëllime të analizës, në këtë ndarje të bilancit të gjendjes, nga seksioni i kapitalit kemi veçuar Rezervat e Rivlerësimit, të cilat lidhen drejtpërdrejt me aktivet afatgjata dhe janë fonde që rezervohen për të mos u përfshirë në kapital, ndërsa të gjithë elementët e tjerë të seksionit të kapitalit i kemi paraqitur të përmbledhur dhe të emërtuar Aktive Neto, të cilat në parim përbëjnë fondin e disponueshëm për kapitalin aksionar të njësive që do rezultojë nga ndarja. Ky fond paraqitet në vlerën 47,200,244,780 lekë dhe përfshin kapitalin ligjor, humbjet e mbartura dhe humbjen e periudhës 6-mujore 2023, duke shkaktuar një zvogëlim të kapitalit aktual. Detaje në pasqyrën në kapitullin 4.2 në faqen 14.

4.3. Rregullimet në bilancin e ndarjes.

Në vlerësimin e bilancit të ndarë sipas parimit të përkatësisë të paraqitur në paragrafin e mëparshëm, duhet të komentojmë disa çështje si vijon.

Së pari, konstatohet se nga paraqitja e aktiveve afatgjata me vlerën e drejtë, si pasojë e rritjes së vlerës së tyre nga rivlerësimi, në seksionin e kapitalit janë krijuar fonde të posaçme në formën e rezervave nga rivlerësimi. Nga rishikimi analitik i listës së aktiveve afatgjata dhe rivlerësimin të tyre, jemi të mendimit se fondi i krijuar në vlerën totale 28,277,863,813 lekë nuk është i mjaftueshëm. Për këtë bazohemi si në parashikimet e standardeve të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, por edhe në zbatim të parimit të kujdesit, i cili sugjeron ruajtjen e rezervave në nivel të arsyeshëm me qëllim ruajtjen e vlerës së kapitalit nga ulje të mundshme të vlerës së aktiveve afatgjata.

Së dyti, nga analiza e llogarive të arkëtueshme, të cila në total paraqiten në vlerën 106,198,128 lekë, rezulton se vlera prej 101,873,758 lekë janë të vjetra ose pa shpresë të arkëtimit apo realizimit të tyre e rrjedhimisht duhet të provizionohen dhe të njihet humbje për këtë vlerë. Kjo duhet bërë jo vetëm në respektim të parimeve të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, por krijimi i shoqërive të reja nga ndarja me aktive të cilat nuk mund të realizohen përbën rrezik për humbjen e vlerës së kapitalit dhe cënimin e aftësive të shoqërive për të vijuar biznesin dhe veprimtaritë në periudhën afatshkurtër.

Së treti, duke parë vlerën e detyrimeve afatshkurtra që i përket secilës shoqëri pritëse sipas parimit të përkatësisë, duam të rezervojmë mundësinë e atribuimit të një pjese prej detyrimeve të tre Sipërmarrësave tek shoqëria pritëse Administruesi i Infrastrukturës sha. Këtë e bazojmë në parimin e sigurimit të ekuilibrit financiar për këto shoqëri. Në kushtet kur nuk ka informacion mbi kohën kur këto shoqëri do të mund të fillojnë kryerjen e veprimarive tregtare, shlyerja e detyrimeve afatshkurtra mund të rezultojnë në prishjene ekuilibrit financiar të shoqërisë dhe cënimin e aftësive të shoqërive për të vijuar biznesin dhe veprimtaritë në periudhën afatshkurtër.

Së katërti, konstatohet se për shoqërinë Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha, aktivet neto rezultojnë negative për vlerën 133,976,428 lekë, për sa Detyrimet janë më të mëdha së Aktivet. Pra, në një ndarje sipas parimit të përkatësisë, kapitali i shoqërisë Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha rezulton negativ, gjë e cila është e pamundur, pasi ligji kërkon që shoqëritë aksionare të kenë një kapital minimal prej 3,500,000 lekë. Kjo mund të zgjidhet nëpërmjet dhënies së aktiveve shtesë ose heqja e disa detyrimeve, të cilat mund ti atribuohen shoqërive të tjera që rezultojnë nga ndarja. Dhënia e aktiveve shtesë, në rastin konkret nuk përbën një zgjidhje të mundëshme, pasi në bilancin e ndarjes nuk identifikohen aktive që mund ti vihen në dispozicion nga njësitë e tjera, të cilat mund ti shërbejnë për veprimtarinë që pritet të kryejë shoqëria Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha. Gjithashtu, përcaktimi i bërë në nenin 6, pika 9, të ligjit 90/2021, sipas të cilit, pasuritë që nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e secilës shoqëri pritëse, i atribuohen Administruesit të Infrastrukturës, nuk lë shumë hapësira në këtë aspekt. Rrjedhimisht, do të analizohet mundësia e heqjes së detyrimeve dhe atribuimin e tyre tek shoqëria Administruesi i Infrastrukturës sha.

Në konkluzion, për përcaktimin e ndarjes së bilancit, do të zbatojmë parimin e përkatësisë, por për të shmangur vështirësitë që paraqiten duhet të bëjmë rregullime të caktuara, të cilat po i përshkruajmë dhe arsyetojmë në vijim.



Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

4.3.1. Komete mbi rregullimet për rezervën e rivlerësimit.

Sikurse shprehemi edhe në paragrafin e mëparshëm, aktivet afatgjata janë paraqitur në pasqyrat financiare me modelin e rivlerësimit. Në këto raste, vlera kontabël e aktiveve rregullohet sipas vlerës së rivlerësuar.

Në rastin kur vlera kontabël e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja akumulohet si tepricë rivlerësimi në seksionin e kapitaleve të veta. Megjithatë, rritja njihet si fitim për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në humbje.

Nëse vlera kontabël e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në humbje. Megjithatë, ulja do të njihet si pakësim i tepricës nga rivlerësimi të njohur më parë për të njëjtin aktiv.

Pra rregullimi i vlerës duhet të kryhet në mënyrë analitike, për secilin element të aktiveve afatgjata më vete dhe jo mbi bazë grupi.

Nga rishikimi i regjistrimeve në kontabilitet të rivlerësimit të aktiveve afatgjata konstatohet se njëësia ka njohur në tepricën e rivlerësimit edhe rritjet edhe uljet si pasojë e rivlerësimit. Ndërsa uljet duhet të ishin njohur në humbje, kjo ka rezultuar me një nënvlerësim të tepricës nga rivlerësimi dhe mbivlerësim të fitimeve të mbartura. Rrjedhimisht duhet të bëhen rregullimet për vlerën si vijon.

Njesia	Llog- ari	Nomeklature	Teprica nga ri- vlerësimi aktuale 30.06.2023	Teprica nga ri- vlerësimi siç duhet	Diferenca për sistemim
NJMBIH	211	Toka ne Degezime	1,468,981,900	1,765,960,300	296,978,400
NJMBIH	211	Toka ne Stacione	2,181,033,377	3,902,957,489	1,721,924,112
NJMBIH	211	Toka Linja kryesore	0	4,269,147,248	4,269,147,248
NJMBIH	212	Ndertesa	383,932,650	886,979,843	503,047,193
NJMBIH	212	Linja Kryesore	21,576,575,830	22,578,912,963	1,002,337,133
NJMBIH	212	Linja ne Stacione	2,425,098,050	2,128,909,330	-296,188,720
NJMBIH	212	Linja ne Degezime	-41,215,066	321,288,649	362,503,715
NJSHML	212	Ndertesa	16,125,233	94,320,267	78,195,034
NJSHML	213	Pajisje e makineri	42,751,953	46,673,944	3,921,991
NJSHML	215	Mjete Transporti	1,323,939	1,987,759	663,820
NJBM	215	Mjete Transporti	102,478,144	99,763,771	-2,714,373
NJBU	215	Mjete Transporti	120,777,442	122,707,716	1,930,274
Drejtoria	218	Pajisje zyre	361	361	0
		Shuma	28,277,863,813	36,219,609,640	7,941,745,827

Vlera prej 7.941.745.827 lekë duhet të njihet në rritje të tepricës nga rivlerësimi dhe në pakësim të fitimeve të mbartura si vijon.

Emërtimi	Tepricë nga rivlerësimi	Humbje të mbartura
Vlera para rregullimit	28,277,863,813	(58,155,181)
Rregullimi i rezervave të rivlerësimit	7,941,745,827	(7,941,745,827)
Vlera pas rregullimit	36.219.609.640	(7,999,901,008)

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

4.3.2.Komente mbi rregullimet për llogaritë e arkëtueshme.

Llogaritë e arkëtueshme për vlerën 101,873,758 lekë duhet të provizionohen dhe të njihet humbje për këto vlera.

Provizionimi i llogarive të arkëtueshme nuk është përfshirë në bilancin e datës 30.6.2023 të përgatitur nga shoqëria Hekurudha Shqiptare sha, pasi drejtimi refuzon kryerjen e këtij veprimi për shkak të rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparëshme të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Theksojmë se provizionimi i llogarive të arkëtueshme nuk i fshin debitorët përkatës nga librat e shoqërisë, por për më tepër i mban ata në evidencë dhe shton llogarinë e provizionit me vlerë negative, duke sjellë paraqitjen e llogarive të arkëtueshme me vlerë neto në pasqyrat financiare, por në librat kontabël do të vijojë të trashëgohet lista e plotë e debitorëve. Në rastin e arkëtimit apo të realizimit të llogarive të provizionuara, vlera përkatëse e provizionit eliminohet dhe njihet në të ardhurat e asaj periudhe ku realizohet arkëtimi.

Si rrjedhim, regjistrmi i këtyre provizioneve kërkon një miratim të posaçëm në Këshillin Mbikqyrës, në mënyrë që të përfshihet në bilancin e ndarjes.

Provizionimi i propozuar i llogarive të arkëtueshme paraqitet në vijim.

	Administruesi i Infrastrukturës	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit	Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore	TOTAL
<i>(Të gjitha vlerat në Lek)</i>					
	30/6/2023	30/6/2023	30/6/2023	30/6/2023	30/6/2023
Llogari të arkëtueshme	23,403,446	125,899	53,462,386	29,206,397	106,198,128
					0
Provizione për klientët	302,281		14,059,591		14,361,872
Provizione për Kërkesa të tjera në konflikt			39,255,387		39,255,387
Provizione për punonjës debitorë	83,810	101,491	97,958		283,259
Provizione për debitorë mungesa inventari				29,206,397	29,206,397
Rregullim i TVSh-së	18,766,843				18,766,843
Shuma provizione	19,152,934	101,491	53,412,936	29,206,397	101,873,758
Llogari të arkëtueshme Neto	4,250,512	24,408	49,450	0	4,324,370

Në vijim po paraqesim vlerën e Aktiveve Neto pas regjistrimit të provizioneve dhe tepricës nga rivlerësimi.

Emërtimi	Vlera Lek
Kapitali ligjor Hekurudha Shqiptare sha	47,450,830,000
Humbje të mbartura (pas rregullimit të tepricës së rivlerësimit AAGj)	(7,999,901,008)
Humbje periudha 6-mujore 2023	(192,430,039)
Humbje nga provizionimi i llogarive të arkëtueshme	(101,873,758)
Aktive neto më 30.6.2023	39,156,625,195

Vlera prej 39,156,625,195 lekë përbën vlerën e disponueshme për kapitalin aksionar për shoqëritë pritëse, nga e cila, vlera prej 2,195 lekë kalon në rezerva të tjera për rrumbullakosje dhe vlera prej **39,156,623,000 lekë destinohet për formimin e kapitalit ligjor.**

4.3.3.Komente mbi rregullimet për detyrimet tregtare.

Sipas librave kontabël, ekzistojnë detyrime afatgjata ndaj hekurudhave të huaja në vlerën 286,342,110 lekë. Gjithashtu, shoqëria Administruesi i Infrastrukturës sha trashëgon detyrime të tjera ndaj hekurudhave të huaja në vlerën 781,465,000 lekë, ndaj për qëllime të administrimit më të mirë, këto detyrime është më e arsyeshme të atribuohen të gjitha tek Administruesi i Infrastrukturës sha duke i konsoliduar kështu sipas natyrës tek e njëjta shoqëri. Në këtë formë arrijmë të eliminojmë edhe problematikën e shfaqur për kapitalin negativ që rezultonte për shoqërinë Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha.

Gjithashtu, llogaritë e pagueshme tregtare afatshkurtra jemi të mendimit që të atribuohen gjithashtu tek Administruesi i Infrastrukturës pasi synohet që sipërmarrësit e transportit dhe të mirëmbajtjes të kenë aftësi për të vijuar veprimtaritë. Trashëgimi i detyrimeve do të vinte në dyshim aftësinë e këtyre sipërmarrësve për të vijuar veprimtaritë në kushte normale, pasi në fazën fillestare të krijimit deri në arritjen e ekuilibrave financiarë këto njësi nuk do të kenë aftësi paguese.

Megjithatë, trashëgimi i detyrimeve nga Administruesi i Infrastrukturës do të përbëjë një sfidë për këtë njësi, pasi vlera e detyrimeve është mjaft e lartë dhe faza fillestare e krijimit të shoqërisë dhe ajo e përfundimit të rehabilitimit të linjave hekurudhore do të zgjasë të paktën edhe për një periudhë dy vjeçare. Kjo do të thotë së asnjë nga shoqëritë pritëse nuk do të jetë në gjendje të krijojë të ardhura nga aktivitetet normale. Për këtë, Administruesi i Infrastrukturës duhet të jetë objekt i një analizë të posaçme dhe strukturimi për afatet e shlyerjes së detyrimeve.

Në konkluzion, vlerësojmë se të gjitha llogaritë e pagueshme tregtare, afatshkurtra dhe afatgjata, duhet ti atribuohen shoqërisë Administruesi i Infrastrukturës sha.

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

4.3.4.Komente mbi rregullimet për inventarët.

Komentojmë se nuk i kemi inspektuar inventarët, por kemi krahasuar listat analitike të tyre të përgatitura nga njësia me gjendjet në librat kontabël.

Nga kontrolli rezulton se për disa vlera të inventarëve nuk disponohet listë analitike në datën 30.06.2023. Vlerat janë si vijon.

Emërtimi	NJBU	NJBMIH	Shuma
Lende Djegëse	4,982,898		4,982,898
Materiale ndihmëse		2,478,856	2,478,856
Produkte mbeturinë dhe skrap	644,800	97,500	742,300
Bileta (me kosto)	2,650,071		2,650,071
Shuma	8,277,769	2,576,356	10,854,125

Gjithashtu, theksojmë se inventarët përfshijnë stoke të trashëguar nga periudha të hershme, çka rrit mundësinë e zhvlerësimit të tyre për shkak të vjetërimit teknologjik. Vetë njësia ka përpiluar lista të inventarëve me qarkullim të ngadalshëm në vlerën 22,950,726 lekë, si vijon.

Emërtimi	NJBU	NJBMIH	Drejtoria	Shuma
Materiale ndihmëse	63,381	22,872,632	14,713	22,950,726

Megjithatë, drejtimi nuk ka llogaritur ndonjë fond për humbje të mundshme të vlerës së inventarëve, si për inventarët pa analizë ashtu edhe për ata me qarkullim të ngadalshëm.



Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

4.4. Bilanci i ndarjes në datën 30.6.2023 pas rregullimeve.

Në vijim paraqitet bilanci i ndarjes i rregulluar, në rastin e ndarjes *me pronësi të drejtpërdrejtë*.

	Administruesi i Infrastrukturës	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit	Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore	TOTAL
<i>(Të gjitha vlerat në Lek)</i>					
	1/7/2023	1/7/2023	1/7/2023	1/7/2023	30/6/2023
AKTIVET					
Aktive afatshkurtra					
Mjete monetare	3,762,021	70,594	220,491	25,698	4,078,804
Disponibilitete ne thesar	151,952,987	0	0	0	151,952,987
Llogari të arkëtueshme	4,250,512	24,408	49,450	0	4,324,370
Inventarët	223,602,260	9,907,053	1,552,926	161,573,852	396,636,091
Totali i aktiveve afatshkurtra	383,567,780	10,002,055	1,822,867	161,599,550	556,992,252
Aktivet afatgjata					
Aktive materiale	76,814,634,245	224,548,154	212,864,123	385,356,615	77,637,403,137
Totali i aktiveve afatgjata	76,814,634,245	224,548,154	212,864,123	385,356,615	77,637,403,137
Totali i aktiveve	77,198,202,025	234,550,209	214,686,990	546,956,165	78,194,395,389
DETYRIMET DHE KAPITALI					
Detyrimet afatshkurtra					
Detyrime të mbajtura në thesar	156,390,495	0	0	0	156,390,495
Llogaritë e pagueshme tregtare	154,929,262	0	0	0	154,929,262
Te pagueshme per punonjesit dhe sigurimet	20,691,770	4,776,517	4,255,428	2,931,409	32,655,124
Të pagueshme per detyrime tatimore	412,727	41,655	32,124	41,826	528,332
Parapagime te arketuara	1,123,192	0	8,738,341	0	9,861,533
Të pagueshme të tjera	7,225,817	167,439	178,656	233,484	7,805,396
Totali i detyrimeve afatshkurtra	340,773,263	4,985,611	13,204,549	3,206,719	362,170,142
Detyrimet afatgjata					
Huamarrjet afatgjata	657,723,254	0	0	0	657,723,254
Llogaritë e pagueshme tregtare AGj	1,067,807,110	0	0	0	1,067,807,110
Të pagueshme të tjera Agj	25,932,037	0	0	0	25,932,037
Grantet dhe të ardhurat e shtyra AGj	467,278,011	0	0	0	467,278,011
Provizione	237,250,000	0	0	0	237,250,000
Totali i detyrimeve afatgjata	2,455,990,412	0	0	0	2,455,990,412
Totali i detyrimeve	2,796,763,675	4,985,611	13,204,549	3,206,719	2,818,160,554
Kapitali dhe fondet e veta					
Kapitali aksionar	38,547,282,000	106,856,000	101,718,000	400,767,000	39,156,623,000
Rezerva te rivleresimit	35,854,156,182	122,707,716	99,763,772	142,981,970	36,219,609,640
Rezerva te tjera	168	882	669	476	2,195
Kapitali total	74,401,438,350	229,564,598	201,482,441	543,749,446	75,376,234,835
Totali i detyrimeve dhe fondet e veta	77,198,202,025	234,550,209	214,686,990	546,956,165	78,194,395,389

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

Në vijim paraqitet bilanci i ndarjes i rregulluar, në rastin e ndarjes *me një grup të kontrolluar*.

	Administruesi i Infrastrukturës (Bilanc Individual)	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve	Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit	Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore	TOTAL (Bilanc i Konsoliduar)
<i>(Të gjitha vlerat në Lek)</i>					
	1/7/2023	1/7/2023	1/7/2023	1/7/2023	1/7/2023
AKTIVET					
Aktive afatshkurtra					
Mjete monetare	3,762,021	70,594	220,491	25,698	4,078,804
Disponibilitete ne thesar	151,952,987	0	0	0	151,952,987
Llogari të arkëtueshme	4,250,512	24,408	49,450	0	4,324,370
Inventarët	223,602,260	9,907,053	1,552,926	161,573,852	396,636,091
Totali i aktiveve afatshkurtra	383,567,780	10,002,055	1,822,867	161,599,550	556,992,252
Aktivët afatgjatë					
Aktive financiare	609,341,000				0
Aktive materiale	76,814,634,245	224,548,154	212,864,123	385,356,615	77,637,403,137
Totali i aktiveve afatgjatë	77,423,975,245	224,548,154	212,864,123	385,356,615	77,637,403,137
Totali i aktiveve	77,807,543,025	234,550,209	214,686,990	546,956,165	78,194,395,389
DETYRIMET DHE KAPITALI					
Detyrimet afatshkurtra					
Detyrime të mbajtura në thesar	156,390,495	0	0	0	156,390,495
Llogaritë e pagueshme tregtare	154,929,262	0	0	0	154,929,262
Te pagueshme per punonjesit dhe sigurimet	20,691,770	4,776,517	4,255,428	2,931,409	32,655,124
Të pagueshme per detyrime tatimore	412,727	41,655	32,124	41,826	528,332
Parapagime te arketuara	1,123,192	0	8,738,341	0	9,861,533
Të pagueshme të tjera	7,225,817	167,439	178,656	233,484	7,805,396
Totali i detyrimeve afatshkurtra	340,773,263	4,985,611	13,204,549	3,206,719	362,170,142
Detyrimet afatgjatë					
Huamarrjet afatgjatë	657,723,254	0	0	0	657,723,254
Llogaritë e pagueshme tregtare AGj	1,067,807,110	0	0	0	1,067,807,110
Të pagueshme të tjera Agj	25,932,037	0	0	0	25,932,037
Grantet dhe të ardhurat e shtyra AGj	467,278,011	0	0	0	467,278,011
Provizione	237,250,000	0	0	0	237,250,000
Totali i detyrimeve afatgjatë	2,455,990,412	0	0	0	2,455,990,412
Totali i detyrimeve	2,796,763,675	4,985,611	13,204,549	3,206,719	2,818,160,554
Kapitali dhe fondet e veta					
Kapitali aksionar	39,156,623,000	106,856,000	101,718,000	400,767,000	39,156,623,000
Rezerva te rivleresimit	35,854,156,182	122,707,716	99,763,772	142,981,970	36,219,609,640
Rezerva te tjera	168	882	669	476	2,195
Kapitali total	75,010,779,350	229,564,598	201,482,441	543,749,446	75,376,234,835
Totali i detyrimeve dhe fondet e veta	77,807,543,025	234,550,209	214,686,990	546,956,165	78,194,395,389

Raport ndarje Hekurudha Shqiptare sha

4.5. Komente mbi Aktivet Afatgjata.

Aktivitet Afatgjata janë ndarë dhe destinuar në njësitë pritëse sipas përkatësisë së tyre. Përkatësia është përcaktuar mbi bazën e origjinës së krijimit të këtyre aktiveve afatgjata, mbi bazën e vendndodhjes aktuale të këtyre inventarëve dhe gjendjes në librat kontabël. Gjithashtu, aktivitet afatgjata janë ndarë edhe në pajtim me parashikimet në nenin 6 të ligjit 90/2021. Bashkëlidhur me raportin gjendet edhe kopje elektronike e listave të aktiveve afatgjata, sipas bilancit kontabël të ndarjes në datën 30 qershor 2023. Të gjitha vlerat janë në Lek.

Lista e aktiveve afatgjata është përditësuar deri në datën 30.6.2023, datë e cila është përcaktuar si datë e ndarjes.

Aktivitet afatgjata janë paraqitur të rivlerësuar me vlerën e drejtë dhe mbi këto vlera është bërë edhe ndarja. Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata është ruajtur dhe do të paraqitet në bilancet e shoqërive pritëse në përputhje me aktivitet afatgjata që ato i takojnë në mënyrë analitike.

Pavarësisht se aktivitet afatgjata janë paraqitur të rivlerësuar me vlerën e drejtë, në respektim të standarteve të mbajtjes së kontabilitetit dhe të raportimit financiar, shoqëritë pritëse duhet të ruajnë informacion mbi vlerën historike para rivlerësimit të aktiveve afatgjata si dhe të përditësojnë regjistrin e aktiveve afatgjata mbështetur në vlerën e drejtë të rivlerësuar por edhe me kostot historike të tyre.

Nga komunikimi me drejtimin e shoqërisë, rezulton se shoqëria është angazhuar në një projekt investimi për rehabilitimin e linjës hekurudhore Tiranë-Durrës si dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, me një vlerë të përgjithshme prej rreth 70 milionë Euro. Kjo kontratë financohet me grante dhe me hua bankare afatgjatë të ofruara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ky projekt ka filluar të zbatohet që nga periudha 2021 dhe parashikohet të dorëzohet në Janar 2025. Megjithëse deri në datën e bilancit të ndarjes të datës 30.6.2023 janë realizuar mbi 30 milionë Euro punime me TVSh, shoqëria nuk e ka paraqitur këtë aktiv në pasqyrat financiare dhe rrjedhimisht ky investim nuk është përfshirë në bilancet e çeljes të paraqitura në këtë raport për shoqëritë pritëse, rrjedhimisht, i takon shoqërisë Administruesi i Infrastrukturës sha të marrë në evidencë dhe të paraqesë në pasqyrat financiare këtë investim sapo të hapë librat kontabël me datë regjistrimi 1/7/2023, menjëherë pas hyrjes në fuqi të ndarjes.

5. Konkluzione

Marrëveshja për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare Sha në shoqëritë pritëse: Administruesi i Infrastrukturës sha, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve sha, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit sha dhe Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore sha është në përputhje me kërkesat e parashikuara në Nenet 216-225 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

Secila nga metodat e pronësisë së aksioneve është e përshtatëshme dhe raporti i këmbimit të aksioneve është i drejtë dhe i arsyeshëm.

Gjykojmë se, megjithë kufizimet për shkak të pasigurive lidhur me inventarët dhe aktivet afatgjata si dhe rezervave të audituesve në pasqyrat financiare vjetore 2022, vlera e përgjithshme e kontributeve nuk është më e vogël se shumta e kapitalit aksionar që zotëron Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 39,156,623,000 lekë.

Nuk u hasën vështirësi të posaçme të cilat meritojnë të përmenden në këtë raport.


Bashkëlidhur këtij raportit gjenden:

- Bilanci i shoqërisë që ndahet në datën 30/6/2023.
- Listat analitike të llogarive të arkëtueshme.
- Listat analitike të detyrimeve.
- Regjistri i aktiveve afatgjata.
- Listat analitike të inventarëve.



Sokol TOSKA

Grupi i Ekspertëve



Aida MALOKU



Vullnetare GELA

31.8.2023